VENDIM
Nr. 159, datë 5.6.2026

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË "ASSA ENERGY SOLUTIONS" SHPK PËR LICENCIM NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa "a", të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; të neneve 4, pika 1, germa "a", 5, pika 1, germa "a", dhe 10, pikat 1 dhe 3, të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe të neneve 15 dhe 19, pika 1, germa "a", të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 5.6.2026, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1641/1 prot., datë 3.6.2026, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës "Mbi kërkesën e shoqërisë 'ASSA Energy Solutions' sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike",

konstatoi se:

- Shoqëria "ASSA Energy Solutions" sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1641 prot., datë 20.5.2026, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga impianti fotovoltaik, me vendndodhje në Sheq-Marinas, Bashkia Fier, qarku Fier, me kapacitet të instaluar 10 mwac.

- Nga shqyrtimi i aplikimit, në referencë të përcaktimeve të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, rezulton se:

Përputhshmëria e aplikimit me rregulloren

- Në përputhje me nenin 9, pika 1 dhe 1.1 të rregullores, aplikuesi ka dorëzuar dokumentacionin e kërkuar për pajisjen me licencë sipas germave "a", "b" dhe "c", duke plotësuar formularin sipas formatit të përcaktuar në shtojcën 1.

- Në përputhje me nenin 9, pika 1.2 të rregullores, aplikuesi ka dorëzuar dokumentacionin juridik dhe administrativ të kërkuar sipas germave "a", "b", "c" dhe "d".

- Në përputhje me nenin 9, pika 1.3 të rregullores, aplikuesi ka dorëzuar dokumentacionin financiar dhe fiskal të kërkuar sipas germave "a" dhe "c".

- Në përputhje me nenin 9, pika 2 të rregullores, aplikuesi ka dorëzuar dokumentacionin specifik për licencim në sektorin e prodhimit të energjisë elektrike sipas germave "c", "d" dhe "e".

Pajisja e shoqërisë me leje dhe miratime të tjera

Shoqëria "ASSA Energy Solutions" sh.p.k.:

- Ka nënshkruar me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), në datën 25.11.2024, "Marrëveshjen për zhvillimin e projektit në lidhje me projektimin, financimin, ndërtimin, funksionimin dhe mirëmbajtjen e një impianti fotovoltaik me një kapacitet të instaluar prej 10 mwac dhe kapacitet të mbështetur prej 10 mwac që do vendoset në Sheq-Marinas, Bashkia Fier, qarku Fier", me nr. 9291 prot., datë 25.11.2024;

- Ka nënshkruar me shoqërinë “Operatori i Sistemit të Transmetimit” (OST) sh.a. “Marrëveshjen për lidhjen në rrjetin e transmetimit të parkut fotovoltaik ASSA” të protokolluar në OST sh.a. me nr. 760/7 prot., datë 15.4.2026 dhe në shoqërinë “ASSA Energy Solutions” sh.p.k., me nr. 13 prot., datë 15.4.2026, për lidhjen e centralit me rrjetin e transmetimit.

- Shoqëria “ASSA Energy Solutions” sh.p.k. është pajisur me vendimin për VNM paraprake me nr. AN 150920250037, datë 12.1.2026, komisioni 05, të lëshuar nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM), për zhvillimin e projektit “Parku fotovoltaik ASSA dhe veprat ndihmese”, me vendndodhje në Njësinë Administrative Topojë, Bashkia Fier.

- Në këtë aplikim duhet të plotësohet dhe sa vijon:

Neni 9. Formati dhe dokumentacioni për aplikim

Pika 1. Dokumentacioni i përgjithshëm për të gjitha aplikimet për pajisje me licencë

Pika 1.2. Dokumentacioni juridik dhe administrativ:

- germa “c”: Shoqëria duhet të japë sqarimet përkatëse në lidhje me bërjen efektive të stafit teknik;

Pika 1.3. Dokumentacioni financiar dhe fiskal:

- germa “b”: Shoqëria duhet të depozitojë vendimet e organeve drejtuese të secilës prej shoqërive ortake të saj, ku të jetë dedikuar shuma përkatëse në kuadër të financimit të 20% të vlerës totale të investimit të projektit;

Pika 2. Dokumentacioni specifik sipas tipit të licencës

2.1”:

- germa “a”: Shoqëria duhet të depozitojë një garanci për panelet që parashikon të përdorë, në rast se e disponon, për të rakorduar afatin e vlefshmërisë së licencës, si dhe të përcaktojë një datë specifike në të cilën parashikon të fillojë operimin e centralit;

- germa “b”: Shoqëria duhet të depozitojë në ERE komunikimin me MIE-n, në lidhje me krijimin e shoqërisë për qëllime të veçanta (SPV) (së cilës, sipas marrëveshjes me MIE-n, i transferohen të gjitha të drejtat, ndër to dhe e drejta e operimit të impiantit), të depozitojë në ERE qëndrimin e MIE-s, në rast se ka pasur një të tillë; të bëjë me dije në rast se e ka nënshkruar marrëveshjen përfundimtare dhe ta depozitojë atë në ERE; si dhe të përditësojë çdo informacion vijues, në lidhje me zhvillimin e projektit;

- germa “e”: Shoqëria duhet të japë informacion, në lidhje me fillimin e punimeve për ndërtimin e centralit, si dhe të bëjë saktësimet përkatëse në lidhje me vendndodhjen e centralit.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “ASSA Energy Solutions” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga impianti fotovoltaik, me kapacitet të instaluar 10 mw, me vendndodhje në Sheq-Marinas, Bashkia Fier, qarku Fier.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës të njoftojë shoqërinë “ASSA Energy Solutions” sh.p.k. dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni të vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për

gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti